



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË KOMUNAVE

Janar-Dhjetor 2015

Prill, 2016

Përmbajtja

HYRJE.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
PJESA 1	7
I. Monitorimi i funksionimit të organeve komunale	7
1. Kuvendet e komunave	7
1.2. Komitetet e përhershme.....	8
1.3. Komitetet e tjera	9
1.4. Komitetet Konsultative	11
1.5. Takimet publike me qytetarë.....	12
1.6. Raportimi i kryetarit në Kuvendin e Komunës	12
1.7. Aktet e kuvendeve të komunave	13
1.8. Publikimi i akteve në faqet zyrtare elektronike të Komunave.....	14
1.9. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave.....	15
1.9.1. Shkeljet ligjore të evidentuara	15
PJESA 2	17
2. Agjenda evropiane dhe bashkëpunimi ndërkomunal.....	17
b) Skema EURED 4.....	26
PJESA 3	33
3.1. Realizimi i të hyrave vetanake	33
3.2. Shpenzimet e Buxheteve Komunale	34
3.2.1. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin	34
3.3. Opinionet e Auditorit të Përgjithshëm	36
Konkluzionet e përgjithshme	38
Rekomandime	41
Shtojca 1 Realizmi i të hyrave vetanake totale të komunave për vitin 2015	43
Shtojca 2.....	44
Pasqyra e shpenzimeve të buxheteve të komunave për vitin 2015	44
Shtojca 2: Pasqyra e shpenzimeve të komunave për vitin 2015	

HYRJE

Raporti vjetor i monitorimit të punës dhe funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës është obligim ligjor që rrjedhë nga Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Ky raport përgatitet çdo vit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe bazohet në monitorimin e punës dhe veprimtarisë njëvjeçare të komunave. Raporti shpalosë aktivitetet kryesore të komunave dhe procesin e monitorimit të punës së tyre nga MAPL si institucion përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave.

Ky raport përmbledhë përparimet dhe sfidat e komunave gjatë realizimit të obligimeve ligjore, ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e punës së tyre, bëhen krahasime lidhur me performancën e komunave në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë të caktuara, si dhe pasqyrohen rastet e shkeljeve ligjore gjatë procesit të nxjerrjes së akteve juridike të komunave.

Qëllimi i raportit është pasqyrimi i aktiviteteve të komunave sipas një procesi monitorues të realizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe prezantimi i aktiviteteve të komunave me qëllim që nga gjetjet e evidentuara, të ndërmerren hapa për përmirësimin e veprimtarisë komunale.

Raporti është i ndarë në katër pjesë kryesore: Pjesa e parë paraqet aktivitetet e kuvendeve të komunave; Pjesa e dytë paraqet aktivitetet e komunave në raport me përmbushjen e detyrimeve nga agjenda evropiane; Pjesa e tretë fokusohet në aktivitetet e komunave në fushën e të drejtave të njeriut si dhe Pjesa e katërt paraqet nivelin e realizimit të buxheteve të komunave dhe opinionet e auditorit të përgjithshëm.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2015 komunat e Republikës së Kosovës kanë realizuar aktivitetet e tyre me qëllim të përmbushjes së obligimeve për ushtrimin e kompetencave komunale, të cilat adresojnë çështjet e zhvillimit të përgjithshëm të politikave në nivel lokal dhe që reflektojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Përgjegjësitë dhe aktivitetet e zhvilluara njëkohësisht përfshijnë edhe obligimet që dalin nga agjenda evropiane për Kosovën.

Gjatë vitit 2015, komunat kanë qenë mjaft aktive në ushtrimin e funksioneve të tyre, sipas agjendës së planifikuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Në kuadër të punës së organeve komunale, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, kuvendet e komunave, bazuar në planet e tyre të punës kanë mbajtur 461 mbledhje, nga të cilat 408 mbledhje të rregullta, 46 të jashtëzakonshme, 6 solemne dhe 1 urgjente. Mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, po ashtu janë ndërmarrë veprime për informimin e qytetarëve lidhur me mbledhjet e mbajtura, aktivitetet e zhvilluara, akteve të miratuara dhe zhvillimeve të përgjithshme në nivel lokal.

Krahas kuvendeve, komitetet e obligueshme kanë shqyrtuar dokumentet fiskale dhe financiare, planet, propozim-vendimet, projekt-rregulloret dhe çështjet tjera financiare. Me qëllim të përforcimit të kualitetit të punës me rastin e ushtrimit të kompetencave të tyre, komunat kanë themeluar 79 komitete të tjera, në fushat si vijon: shëndetësi dhe mirëqenie sociale, arsim dhe kulturë, zhvillim ekonomik, planifikim hapësinor, shërbime publike, etj. Gjithashtu, në 17 komuna janë themeluar komitete konsultative, në përbërje të qytetarëve të cilët janë zgjedhur përmes konkurseve publike me mandat 3 vjeçar. Përveç kësaj janë përdorur edhe mekanizmat e tjerë për përfshirjen e qytetarëve, duke i kushtuar rëndësi të veçantë organizimit të takimeve publike me qytetarë. Në përgjithësi komunat kanë qenë brenda normës ligjore, të përcaktuar për mbajtjen e takimeve të obligueshme me qytetarë.

Në mesin e përgjegjësisë ligjore me rëndësi të veçantë është edhe raportimi i kryetarit në kuvendin e komunës. Raportimet e rregullta parashihen të bëhen për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, por mund të kërkojnë edhe raportime të kohëpaskohshme për çështje të ndryshme të cilat vlerësohen të rëndësishme nga kuvendet e komunave. Sipas të dhënave, raportimi i obligueshëm nuk është përmbushur nga kryetarët e komunave: Prishtinë, Glllogovc, Klinë, Novobërdë, Partesh dhe Klllokot.

Gjatë periudhës raportuese, komunat kanë qenë mjaft aktive në miratimin e akteve nënligjore komunale, vendimeve, planeve dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për funksionimin e tyre. Kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1648 vendime dhe 162 Rregullore. Më aktive në miratimin e akteve komunale kanë qenë komunat: Pejë, Gjakovë, Novobërdë, Klinë, Gjilan, Obiliq, Rahovec, Malishevë, Ferizaj, Kaçanik, Mitrovicë Jugore.

Nga 1810 akte të aprovuara, në faqet zyrtare elektreonike të komunave janë publikuar 1729 akte, ose shprehur në përqindje 95%.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave, autoriteti mbikëqyrës ka konstatuar 39 shkelje ligjore në 17 komuna. Pas kërkesës për rishqyrtim të akteve, komunat i kanë harmonizuar 26 akte, 10 akte të kundërligjshme nuk janë harmonizuar me ligj, ndërsa 3 akte edhe pse janë rishqyrtuar në kuvendet e komunave, nuk janë harmonizuar sipas rekomandimeve të dhëna.

Komunat kanë ndërmarrë një numër aktivitete të cilat ndërlidhen me zbatimin e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane. Institucionet e nivelit lokal kanë përfituar nga programet për ngritjen e kapaciteteve, dhe gjatë vitit 2015 janë trajnuar gjithsej 2079 zyrtarë komunal. Përveç kësaj, 19 komuna kanë hartuar programet e tyre për ngritje të kapaciteteve. Po ashtu, janë ndërmarrë hapa në drejtim të përmirësimit të transparencës komunale, ofrimit të kushteve për qasje në dokumentet publike, si dhe janë organizuar 581 konsultime me qytetarë lidhur me hartimin e akteve nënligjore dhe vendimeve të ndryshme në kuadër të kompetencave komunale. Në kuadër të veprimeve për përkrahjen e organizatave joqeveritare, komunat kanë ndarë mjete buxhetore për financimin e aktiviteteve të tyre. Një pjesë e komunave kanë themeluar Zyrat për promovimin e investimeve si obligim nga PVMSA. Megjithatë, në kuadër të obligimeve nga agjenda evropiane mbetet sfiduese zbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Janë gjithsej 40 vendime të cilat akoma nuk janë adresuar nga komunat përkatëse, me qëllim të zbatimit të tyre.

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, gjatë periudhës raportuese kanë funksionuar Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut. Një pjesë e komunave kanë të punësuar persona me aftësi të veçanta, por duhet të hartohen politika lokale për integrimin e kësaj kategorie të personave, duke përfshirë hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Aktualisht ky plan është hartuar vetëm në 11 komuna. Komunat po ashtu duhet të themelojnë Komitetet Konsultative për personat me aftësi të kufizuara. Me gjithë trendin pozitiv të përfshirjes së femrave në jetën institucionale si dhe përkrahjen e bizneseve të tyre, ekziston nevoja e përfshirjes së femrave në pozita vendimmarrëse. Plani për integrimin e komunitetit RAE është hartuar në 19 komuna, ndërsa komunat e tjera duhet të përmbushin këtë obligim, me qëllim të integritetit të këtij komuniteti. Respektimi i gjuhëve është konsistent me nevojat e paraqitura, megjithëse ka vështirësi për shkak të stafit të kufizuar për përkthim.

Gjatë vitit 2015, komunat kanë shtuar aktivitetin në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal. Megjithatë ende ka nevojë për përforsimin e kapaciteteve të komunave në këtë proces. Sipas të dhënave, 14 komuna kanë lidhur gjithsej 41 marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal, kryesisht në fushën e infrastrukturës, ambientit, kulturës dhe turizmit. Prej skemave të financuara nga BE, komunat kanë përfituar nga programet: “Kosova e Bukur”, Projektet EURED IV, Projektet e grant skemës rurale 2013-2015, MUNIFRA (infrastruktura), si dhe projektet e bashkëpunimit ndërkufitar.

Sa i përket buxheteve komunale, në vitin 2015, komunat kanë planifikuar të hyra vetanake në vlerë prej 74,243,215.00 €. Planifikimi në këtë vit ka qenë më i madh se në vitin 2014 sa ishte në vlerën prej 67,285,971.00 €. Në vitin 2015 komunat kanë mbledhur të hyra vetanake në vlerën prej 58,364,205.40€ ose 79% nga niveli i planifikimit vjetor prej 74,243,215.00€,

apo 2,566,621.38€ (ose 4,2%) të hyra vetanake më pak se në vitin 2014 sa ishin 60,930,226.78€. Sa u përket shpenzimeve, në vitin 2015 komunat kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 412,837,588.65€ ose 90% të buxhetimit të vlerës totale prej 456,575,573.41€.

Opinionit i auditorit të përgjithshëm, i cili më së shumti është dhënë në vitet 2013 dhe 2014 është opinion pa rezervë (i pa kualifikuar) me theksim të çështjes. Opinionit i cili iu mundëson komunave për të filluar me procedura të huasë komunale është opinionit pa rezervë (pa kualifikim). Këtë opinion e kanë marrë 2 komuna në vitin 2013 (Shtime dhe Ranullug), ndërsa në vitin 2014 e ka marrë vetëm 1 komunë (Hani i Elezit). Megjithatë për të plotësuar kriterin për huamarrje, komuna duhet të dëshmojë marrjen e opinionit të pa rezervë në dy vitet e fundit, sipas të dhënave ky kriter nuk është plotësuar në asnjë komunë.

PJESA 1

I. Monitorimi i funksionimit të organeve komunale

1. Kuvendet e komunave

Kuvendi i komunës është organi më i lartë vendimmarrës në komunë. Përgjegjësitë dhe kompetencat e kuvendit të komunës burojnë nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe ligjet tjera të cilat rregullojnë çështje të ndryshme nga fusha e vetëqeverisjes lokale. Kuvendi i Komunës ka përgjegjësinë për miratimin e akteve kryesore juridike nënligjore të cilat sigurojnë mbarrëvajtjen dhe funksionimin efikas të komunës. Këto akte janë burim kryesor i të drejtës për nxjerrjen e akteve të tjera administrative të cilat miratohen nga ekzekutivi i komunës. Për të ushtruar kompetencat, kuvendi i komunës mbledhet në baza të rregullta periodike, apo në raste të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe urgjente.

1.1.Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit¹.Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

Në vijim kemi paraqitur grafikun me numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave:




Fig.1. Numri i mbledhjeve të kuvendeve të rregullta, jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente

Nga figura 1 shihet se numrin më të madh të mbledhjeve e kanë mbajtur kuvendet e komunave: Prizren, Kamenicë; Graçanicë; Shtime; Malishevë, Klokot dhe Rahovec.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, me përjashtim të Komunës së Prishtinës, të gjitha komunat e tjera kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e 10 mbledhjeve të parapara gjatë vitit.

¹ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.



Fig.2. Numri i përgjithshëm mbledhjeve të kuvendeve të komunave

Në shumicën e komunave, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqeve zyrtare të komunave, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, mediave të shkruara dhe elektronike, si dhe forma të tjera të informimit publik.

Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës dhe prezencës fizike të monitoruesve. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2012/01 për monitorim elektronik të kuvendeve të komunave, komunat janë të obliguara të sigurojnë qasje në sistemin e teleprezencës. Gjatë kësaj periudhe, ky sistem në disa raste nuk ka funksionuar në Komunën e Pejës dhe Klinës, ndërsa ende nuk është vendosur në komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

1.2. Komitetet e përhershme

Me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme për të mbështetur punën e tyre. Komitete të përhershme sipas nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale janë: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit. Mbi këtë bazë, puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës, andaj ky komitet zakonisht takimet i mban para mbledhjeve të kuvendit të komunës. Rendi i ditës së komiteteve, rregullohet më konkretisht me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave. Të njëjtat rregulla duhet të vlejë edhe për komunitetin për komunitete, si mekanizëm për përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Komitetet për Politikë dhe Financa më tepër janë fokusuar në trajtimin e çështjeve të natyrës financiare, siç janë: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, rishikimit të buxhetit, rregulloreve komunale, planeve rregulluese urbane dhe propozim

vendimeve për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë. Për dallim nga KPF, Komitetet për komunitete kanë trajtuar çështjet e ndërlidhura me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në komuna.

Gjatë periudhës raportuese, Komitetet për Politikë dhe Financa kanë mbajtur 371 takime, kurse Komitetet për Komunitete 303. Krahësuar aktivitetin e tyre, shihet se komiteti për komunitete ka mbajtur 63 takime më pak se Komiteti për Politikë dhe Financa.

Në vijim është paraqitur numri i takimeve të këtyre komiteteve sipas komunave:




Fig.3. Numri i mbledhjeve të komiteteve të obligueshme

Nëse krahasojmë numrin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete me mbledhjet e Kuvendit të Komunës, atëherë të dhënat tregojnë se nuk ka ndërlidhshmëri mes tyre, siç shihet edhe nga figura e mëposhtme:




Fig.4. Të dhënat krahasuese mes mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të përhershme

Sipas të dhënave të figurës së mësipërme, shohim se në 92 raste mbledhjet e kuvendeve të komunave janë zhvilluar pa mbajtjen paraprake të mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Ndryshe nga to, 168 mbledhje të kuvendeve të komunave janë zhvilluar pa mbajtjen paraprake të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete.

1.3. Komitetet e tjera

Kuvendi i komunës mund të themeloj komitete të tjera profesionale² nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Për dallim nga to, Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Gjatë kësaj periudhe është parë se një pjesë e madhe e komunave kanë themeluar komitete në fushat si: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Arsimit dhe Kulturë; Zhvillim Ekonomik; Planifikim Hapsinor; Shërbime Publike. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komiteve të tjera të themeluara në komuna:




Fig.5. Numri i komiteve të tjera në komuna sipas fushave

Siç shohim nga figura e mësipërme, në komuna janë themeluar gjithsej 79 komitete të tjera në fushat e paraqitura si më lartë. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për shëndetësi, arsim, urbanizëm dhe shërbime publike.

Më poshtë, është paraqitur tabela me llojet e komiteve të tjera të cilat janë të themeluara në komuna:

²Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 51.2

KOMITETET E TJERA	KOMUNAT	NUMRI
KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj, Podujevë, Peja, Klina, Lipjani, Malisheva, Prizreni, Deçani, Juniku	14
KOMITETI PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT	Deçan, Prizren, Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj, Podujevë, Peja, Klina, Lipjani, Shtime, Malishevë	15
KOMITETI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	Prizren, Gjilan, Prishtinë, Podujevë, Deçani	5
KOMITETI PËR BUJQËSI	Fushë Kosovë, Lipjan	2
KOMITETI PËR ZHVILLIM EKONOMIK	Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj, Podujevë, Pejës, Klina	9
KOMITETI PËR URBANIZËM	Deçan, Prizren, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Klina, Lipjani,	7
KOMITETI PËR SHËRBIME PUBLIKE	Prizren, Fushë Kosovë, Gjilan, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Junik, Prishtinë, Viti, Pejës, Klina, Deqani	11
KOMITETI PËR PRONË	Gjilan	1
KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR	Fushë Kosovë, Ferizaj, Malisheva	3
KOMITETI PËR KATEGORITË E DALA NGA LUFTA	Ferizaj,	1
KOMITETI PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR	Gjilan	1
KOMITETI PËR BARAZI GJINORE	Prizren, Gjilan, Mitrovicë Jugore,	3
KOMITETI PËR DIASPORE	Malisheva	1
KOMITETI PËR RI INTEGRIM	Istogu	1
KOMITETI PËR PLANIFIKIM URBAN	Peja, Lipjani, Ferizaj, Malisheva	4
	Totali	78

Tab.1: Llojet e komiteve të tjera të themeluara në komuna

Përkundër faktit se janë themeluar një numër i konsiderueshëm i këtyre komiteve, në pak raste është vërejtur se këto komite shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme. Pengesë është parë edhe mungesa e kompensimit të punës së këtyre komiteve, që ka ndikuar në uljen e ritmit të punës së tyre.

1.4. Komitetet Konsultative

Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme të natyrës konsultative për të mbështetur punën e tyre. Këto komite duhet të themelohen për sektor specifik të përcaktuara nga komuna, sipas prioriteteve dhe me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Sipas të dhënave, nga 38 komuna vetëm 17 komuna kanë themeluar komitetet konsultative. Kuvendet e Komunave të cilat kanë

themeluar Komitetet Konsultative janë si vijon: Lipjan, Kamenicë, Hani i Elezit, Gjilan, Viti, Podujevë, Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Gjilan, Pejë, Istog, Klinë, Glogoc, Vushtrri, Malishevë dhe Skenderaj.

1.5. Takimet publike me qytetarë

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin vendimmarrës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Komunitet janë të obliguara të respektojnë parimet kushtetuese dhe dispozitat ligjore për të siguruar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin vendimmarrës, përmes komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, diskutimeve publike me rastin e propozimit të akteve komunale, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Organizimi i takimeve publike me qytetarë dallon nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë, e disa të tjera kanë qenë të rezervuara në këtë drejtim. LVL, në mënyrë të veçantë ka specifikuar konsultimet gjithëpërfshirëse, ku kërkohet mbajtja e së paku dy takimeve publike brenda një viti (neni 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale). Të dhënat e në vijim tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë:




Fig.6. Numri i takimeve publike me qytetarë në komuna

Siç shihet nga figura e mësipërme, shumica e komunave qëndrojnë brenda normës ligjore të përcaktuar, me përjashtim të Komunës së Fushë-Kosovës e cila nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetarë. Gjithashtu, Komunitet: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok, kanë mbajtur vetëm nga një takim me qytetarë duke mos përmbushur normën sipas me nenit 68.1 të LVL-së. Numri i përgjithshëm konsultimeve publike me qytetarë (përfshirë konsultimet lidhur me propozim-aktet, propozim-buxhetet, planet komunale etj.) është paraqitur në pjesën e II të këtij Raporti, tek Agjenda Evropiane.

1.6. Raportimi i kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësisë të kryetarit të komunës është edhe raportimi para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese. Kjo detyrë

duhet të përmbushet së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës (neni 58, pika j e LVL-së). Raportimi i kryetarit është formë e bashkëpunimit me kuvendin e komunës dhe mundëson funksionimin komplementar të dy organeve.

Sipas të dhënave të mbledhura për numrin e raportimeve të kryetarëve në kuvendet e komunave, numri i raportimeve është si vijon:




Fig.7. Numri i raportimeve të kryetarëve të komunave

Nga figura e mësipërme shihet se kryetarët e komunave: Prishtinë, Glllogoc, Klinë, Novobërdë, Partesh dhe Klokot nuk e kanë përmbushur obligimin për raportim në kuvendin e komunës së paku dy herë brenda vitit.

1.7. Aktet e kuvendeve të komunave



Kompetencë themelore e Kuvendit të Komunës është miratimi i vendimeve dhe rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë aktet të nevojshme për funksionimin efikas të komunës.

Në periudhën janar-dhjetor 2015, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1648 vendime dhe 162 Rregullore. Kuvendet kanë miratuar akte nga fusha të ndryshme si: nga fusha financiare miratimi i buxhetit, miratimi i kornizës afatmesme buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, akte për bartjen e mjeteve financiare nga viti fiskal paraparak në vitin 2015, fusha e ambientit, miratimin e planeve rregulluese urbane, miratimi planeve të efijences, miratimi i akteve për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, etj. Për nga aspekti numerik, në vijim është prezantuar figura e akteve të miratuara sipas komunave:




Fig.8. Numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave

Sipas figurës 8, më aktive në miratimin e akteve komunale kanë qenë komunat: Vushtrri, Pejë, Gjakovë, Novobërdë, Klinë, Gjilan, Obiliq, Rahovec, Malishevë, Ferizaj, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, etj.

1.8. Publikimi i akteve në faqet zyrtare elektronike të Komunave



Përgjegjësia për publikimin e akteve të Komunave dhe përditësimin e faqeve elektronike zyrtare të komunave me aktet juridike të miratuara është rregulluar me Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Gjatë kësaj periudhe raportuese, përditësimi i faqeve elektronike të komunave me aktet e miratuara ka qenë koherent. Më

poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat sipas komunave, lidhur me publikimin e akteve në faqet elektronike:




Fig.9. Numri i akteve të publikuara në ueb-faqet zyrtare të komunave

Nga të dhënat e prezantuara shihet se nga 1810 akte të aprovuara, janë publikuar 1729 akte, ose shprehur në përqindje 95%.

1.9. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve për të cilat shprehimisht nuk është kompetent ndonjë autoritet tjetër. Komunitat kanë përgjegjësi që sipas nenit 80 të LVL-së të dërgojnë aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Gjatë vitit 2015 komunitat kanë dërguar aktet e miratuara për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Mirëpo, shumica e kryetarëve të komunave nuk kanë dërguar listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi i komunës, sipas nenit 80.1 të LVL-së. Në këtë aspekt, si shembull i mirë duhet të merret Komuna e Gjilanit, Prizrenit dhe Mitrovica Jugore të cilat kanë dërguar listën me aktet e miratuara.

1.9.1. Shkeljet ligjore të evidentuara



Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave janë konstatuar 39 shkelje ligjore në 17 komuna. Sa i përket numrit të shkeljeve ligjore të kuvendeve të komunave me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore, në vijim është paraqitur grafiku me të dhënat e përgjithshme:




Fig.10. Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara

Pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të akteve, komunitat i kanë harmonizuar 26 akte konform kërkesës për harmonizim, 10 shkelje ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës, ndërsa 3 akte edhe pas rishqyrtimit në kuvendet e komunave nuk janë harmonizuar sipas kërkesës së organit mbikëqyrës. Komunitat të cilat

kanë rishqyrtuar aktet e kundërligjshme duke i harmonizuar me ligjet përkatëse janë: Vushtrri (1 akt), Gjiilan (1), Obiliq (1), Novobërdë (10), Ferizaj (2), Klinë (1), Gjakovë (1), Prizren (1), Graçanicë (1), Ferizaj (1), Rahovec (1), Kamenicë (1). Komunitat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar aktet në kuvendet e komunave pas kundërshtimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës janë: Prishtinë (1), Gjakovë (1), Partesh (1), Klokot (1), Malishevë (1), Lipjan (3), Obiliq (1), Novobërdë (1). Ndërsa komunitat të cilat i kanë rishqyrtuar aktet, por që përsëri nuk i kanë harmonizuar me ligj sipas rekomandimeve përkatëse të nivelit qendror, janë: Malishevë (2) dhe Graçanicë (1).

Në vijim është paraqitur figura me të dhënat numerike të shkeljeve ligjore në komunita:



Fig.11. Numri i përgjithshëm i shkeljeve sipas komunave

Natyrat e vendimeve të kundërligjshme për të cilat MAPL ka kërkuar nga komunitat t'i rishqyrtojnë dhe ti harmonizojnë me legjislacionin në fuqi, i përket: dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, këmbimin të pronës komunale, bartjen e pronës shoqërore në pronë komunale, procedurave për shpalljen e pronave komunale me interes të përgjithshëm, vendimeve për ndryshim dhe plotësim të statuteve komunale, vendimeve për bashkëfinancim të projekteve kapitale në komunitë, vendimet për kushtëzimin e qytetarëve për kryerjen obligimeve ndaj shërbimeve publike, si dhe vendimet për miratimin e deklaratave për asociacionin e komunave.

PJESA 2

2. Agjenda evropiane dhe bashkëpunimi ndërkomunal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse edhe sa i përket koordinimit të agjendës evropiane në raport me komunat. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, në vazhdimësi është punuar në bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve me Ministrinë e Integrimit Evropian, ministritë e linjës, komunat, Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, në mënyrë që të arrihet progres i dëshiruar drejt zbatimit të kriterëve të përcaktuara nga BE.

MAPL në bashkëpunim të ngushtë me komunat, ka hartuar 38 planet të integruara komunale, me qëllim të adresimit të obligimeve të komunave nga procesi i stabilizimit asociativ, dialogut të liberalizimit të vizave si dhe sfidave nga raportet e progresit. Bazuar në këto plane individuale, komunat kanë raportuar mbi baza tre-mujore.

Raporti i hartuar pasqyron aktivitetet e ndërmarra nga komunat për periudhën janar – dhjetor 2015, konkretisht aktivitetet për 38 komuna të Republikës së Kosovës lidhur me procesin e integrimit evropian, sfidave për zbatim dhe rekomandimet gjatë periudhës një vjeçare.

Raporti i obligimeve të komunave nga agjenda evropiane është i fokusuar fusha kryesore siç janë:

2.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal

Janë mbajtur 885 trajnime nga niveli qendror për zyrtarët komunal në 38 komuna. Përfitues nga këto trajnime kanë qenë gjithsej 2079 zyrtarë të komunave.

2.2. Ngritja e transparencës së punës dhe vendimmarrjes në nivelin lokal

Komunat kanë bërë shpalljet për ngjarjet publike të organeve komunale. Njoftimet janë publikuar në faqet zyrtare elektronike të komunave, si dhe mediet elektronike dhe të shkruara.

2.3. Qasja në dokumentet publike

Gjatë vitit 2015, numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në 33 komuna ka qenë 830, kurse 5 komuna (Junik, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan dhe Leposaviq) nuk kanë pasur kërkesa për qasje në dokumente publike.

2.4. Konsultimet publike të mbajtura në komuna

Në 38 komuna janë mbajtur 581 konsultime publike me qytetarë, para miratimit të projekt-akteve të komunës, propozim-buxheteve, planeve, rregulloreve etj.

2.5. Përmirësimi i veprimtarisë së organeve lokale për përmbushjen e mandatit të tyre ligjor

Komunat kanë qenë të obliguara për themelimin e Zyrës për promovimin e investimeve. Kjo zyrë është themeluar në 10 komuna, si: Drenas, Viti, Skenderaj, Lipjan, Dragash, Novobërdë, Gjakovë, Gjiilan, Shtime dhe Suharekë.

2.6. Ndarja e hapësirave të punës institucionit të Avokatit të Popullit

Krijimi i hapësirave për veprimin e avokatit të popullit në komuna është një nga kriteret e agjendës evropiane, e cila bënë pjesë në sferën e administratës publike. Lidhur me këtë kriter, Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit, Pejës, Ferizajt, Gjakovës, Graçanicës, Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës veriore kanë siguruar hapësirat e nevojshme të punës për institucionin e Avokatit të Popullit.

2.7. Administrata publike

Komunat kanë punuar në hartimin e programit për ngritjen e kapaciteteve për shërbyesit civil në administratën komunale. Sipas të dhënave 19 komuna e kanë hartuar programin për ngritje të kapaciteteve, duke përfshirë komunat: Klinë, Junik, Deçan, Drenas, Viti, Klllokot, Graçanicë, Fushë Kosovë, Kaçanik, Istog, Podujevë, Hani i Elezit, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Ferizaj, Prizren, Shtime dhe Vushtrri.

2.8. Sigurimi i respektimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Numri i përgjithshëm i vendimeve të Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për 27 komuna të Republikës së Kosovës ka qenë 216. Prej tyre, 27 komuna kanë zbatuar vendime të Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndërsa 2 komuna (Klinë dhe Malishevë) janë në proces të zbatimit të 8 vendimeve, si dhe 5 komuna (Pejë, Mitrovicë, Klllokot, Prishtinë dhe Malishevë) 40 vendime nuk i kanë zbatuar. Kurse, 11 komuna (Junik, Skenderaj, Shtërpçë, Fushë Kosovë, Istog, Hani Elezit, Novobërdë, Zubin Potok, Mamushë, Mitrovicë Veriore dhe Leposaviq) në vitin 2015 nuk kanë pasur vendime të KPMSHC-së.

2.9. Rritja e bashkëpunimit në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës është një nga veprimet që duhet forcuar në kontekst të zhvillimit të demokracisë

Gjatë periudhës raportuese 22 komuna kanë ndarë buxhet në vlerë prej 1,882,550.27€ për financimin e aktiviteteve të OSHC-ve. 13 komuna nuk kanë ndarë buxhet për këtë qëllim, duke përfshirë komunat: Junik, Klllokot, Shtërpçë, Prishtinë, Dragash, Hani Elezit, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Malishevë dhe Ferizaj. Ndërsa 3 komuna (Shtime, Obiliq dhe Leposaviq) nuk kanë ofruar informacione. Në 22 komuna janë realizuar 437 projekte. Komunat të cilat nuk kanë realizuar ndonjë projekt janë: Junik, Deçan, Klllokot, Shtërpçë, Prishtinë, Dragash, Hani i Elezit, Mamushë, Ranillug, Partesh, Novobërdë, Mitrovicë Veriore, Suharekë, Shtime, Zveçan dhe Leposaviq.

2.10. Krijimi i mekanizmave për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit, si dhe ashpërsimin e sanksioneve lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit

Sipas legjislacionit në fuqi, zyrtarët komunal të obliguar për deklarimin e pasurisë, kanë përmbushur detyrimet ligjore. Lidhur me numrin e deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal dhe anëtarët e kuvendit të komunës me rastin e marrjes së vendimeve, në 32 Komuna nuk ka pasur deklarime të konfliktit të interesit, ndërsa në 5 Komuna (Klinë, Kamenicë, Istog, Dragash dhe Malishevë) ka pasur 13 raste të deklarimeve të konfliktit të interesit.

2.11. Përmirësimi i perceptimit publik me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në prokurim publik

Në 33 Komuna është bërë shpallja publike për aktivitetet e prokurimit në faqen zyrtare të komunës, si dhe janë ofruar informata përmes faqes zyrtare të komunës për përfituesit, 2 komuna (Viti dhe Ranillug) nuk i kanë publikuar shpalljet publike, Komuna e Klllokotit nuk ka ofruar përgjigje në një pyetje.

2.12. Promovimi dhe fuqizimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

2.12.1. Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJDNJK)

Si mekanizma për promovimin e të drejtave të njeriut në komuna, NJDNJK-të funksionojnë në 34 komuna, ndërsa në Komunitet të Veriut të Kosovës ende nuk janë themeluar. Vështirësitë me të cilat përballen zyrtarët e këtyre njësive janë të shumta, por në veçanti kanë të bëjnë me detyrat shtesë të cilat u janë caktuar (krahas detyrave për të drejtat e njeriut). Sipas të dhënave, zyrtarët e 19 njësive të komunave kanë detyra shtesë. Në 10 komuna zyrtarët e Njësive nuk kanë detyra shtesë, kurse 5 komuna nuk kanë ofruar të dhëna në këtë drejtim. NJDNJK-të nuk kanë linjë të veçantë buxhetore, edhe pse një gjë e tillë është përcaktuar me nenin 10.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.2011/04 për NJDNJK.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat përkatëse sipas komunave:




Fig.12. Përbërja e NJDNJK-ve

Në total janë të angazhuar 83 zyrtarë në Njësitet për të Drejtat e Njeriut në Komuna, prej të cilëve 45 janë meshkuj dhe 41 femra.

2.12.2. Themelimi i Komisionit për Ankesa

Në 33 komuna është funksionalizuar komisioni për shqyrtimin e ankesave në komunë, derisa 2 komuna (Graçanicë, Mamushë) nuk e kanë funksionalizuar këtë komision. Numri i përgjithshëm i ankesave që janë trajtuar në 18 komuna është 823. Në 17 komuna (Junik, Deçan, Pejë, Kamenicë, Kllokot, Shtërpçë, Graçanicë, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Partesh, Mitrovicë Veriore, Malishevë, Obiliq, Prizren, Mamushë, Zveçan dhe Leposaviq) nuk ka pasur ankesa, derisa 2 komuna (Vushtrri dhe Novobërdë) nuk kanë ofruar informacion.

2.12.3. Të drejtat e fëmijëve

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, institucionet e nivelit qendror dhe lokal kanë krijuar mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Komunitet të cilat nuk kanë zyrtar për të drejtat e fëmijëve siç është: Suhareka, Vitia, Deçani, Glogovci, Novobërda dhe Mamusha, duhet të ndërmarrin veprime konkrete për angazhuar stafin administrativ në mënyrë që kompletohet struktura e Njësiave për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, 18 Komuna e kanë hartuar Rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa 20 komunitet të tjerë (Klinë, Junik, Deçan, Rahovec, Kllokot, Shtërpçë, Graçanicë, Prishtinë, Zubin Potok, Fushë Kosovë, Podujevë, Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Malishevë, Suharekë, Obiliq, Novobërdë, Zveçan dhe Leposaviq) ende nuk e kanë hartuar këtë rregullore.

Komunitet në vazhdimësi kanë ushtruar monitorimin e procesit mësimor, kanë investuar në infrastrukturën shkollore, ngritjen e cilësisë së mësimdhënësve, ruajtjen e shëndetit të nxënësve, parandalimin e dhunës në shkollë, parandalimin nga dukuritë negative ngritjen e vetëdijes së personelit arsimor dhe nxënësve për të drejtat e tyre, parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve, braktisjen e shkollës duke përfshirë edhe parandalimin e martesave të hershme.

Pavarësisht nga kjo, si rezultat i faktorëve të shumtë socio-ekonomik, megjithë angazhimet e komunave, braktisja e shkollimit nga nxënësit mbetet një dukuri shqetësuese. Sipas të dhënave, deri tani kanë braktisur shkollimin gjithsej 1972 nxënës. Prej tyre, nga klasa 1-9 kanë braktisur mësimin 527 nxënës, prej të cilëve 273 meshkuj dhe 254 femra. Kurse nga klasa 10-12 shkollimin e kanë braktisur 1445 nxënës, nga të cilët 1120 meshkuj dhe 325 femra³.

³Të dhënat janë marr nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me numrin e fëmijëve që e kanë braktisur shkollën gjatë vitit shkollor 2014/2015




Fig.13. Fëmijët që kanë braktisur shkollimin, viti shkollor 2014/2015

Duke marrë parasysh këtë problem, me qëllim të menaxhimit më të mirë të rasteve për fëmijët në rrezik, 6 komuna (Mitrovica, Podujeva, Juniku, Skënderaj, Kllokoti dhe Lipjani). kanë themeluar task-forcat për këtë qëllim. Gjithashtu, në 11 komuna veprojnë Këshillat Lokale të Veprimit. Duke marrë parasysh rolin e zyrtarëve të NJDNJK-ve për të drejtat e fëmijëve, komunat duhet të angazhojnë strukturat e tyre në përmbushjen e objektivave strategjike dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni në fuqi për të drejtat e fëmijëve.

2.12.4. Të drejtat e personave me aftësi të veçanta

Në 26 Komuna janë të punësuar 96 persona me aftësi të veçanta. Në komunën e Mitrovicës ka persona të evidentuar me aftësi të veçanta të cilët punojnë në komunë, mirëpo nuk janë ofruar të dhëna lidhur me numrin e tyre. Për dallim nga to, në 9 komuna (Kamenicë, Kllokot, Graçanicë, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore) nuk ka të punësuar me aftësi të veçanta, kurse Komuna e Skenderajt dhe Leposaviqit nuk kanë ofruar të dhëna në këtë drejtim.

Në kuadër të obligimeve që dalin nga legjislacioni për të drejtat e njeriut, 11 komuna e kanë hartuar Planin Lokal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, si: Gjilani, Prizreni, Ferizaj, Viti, Podujeva, Peja, Obiliq, Shtimja, Kamenica, Skenderaj dhe Rahoveci.

Gjithashtu, janë organizuar takime me komunat për dhënien e udhëzimeve për forimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara. Këtë Komitet e kanë formuar komunat: Deçan, Glllogovc, Ferizaj, Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Suharekë, Gjakovë dhe Prizren. Komunat e tjera kanë raportuar se janë në proces të hartimit të planeve dhe formimit të komiteteve për PAK.

2.13. Fuqizimi i rolit dhe pozitës së femrës në shoqëri

Në bazë të ligjit për barazi gjinore komunat obligohen të emërojnë zyrtarin përgjegjës për barazi gjinore. Në komunat si: Graçanicë, Ranillug, Mamushë, Junik dhe Kamenicë, nuk janë emëruar zyrtarët për barazi gjinore.

Në 36 Komuna janë gjithsej 230 femra në pozita menaxheriale. Komunat të cilat nuk kanë të punësuar femra në pozita menaxheriale janë: Klllokoti dhe Mamusha. Në 38 komuna, përfshirë administratën dhe kuvendet e komunave, numri i përgjithshëm i femrave të punësuar është 2127. Megjithatë, numri i femrave të përfshira në shërbimin civil është shumë më ulët. Nëse analizohen të dhënat, më dobët qëndron Komuna e Hanit të Elezit, në të cilën nga 53 shërbyes civilë, janë të angazhuara vetëm 4 femra. Në përgjithësi, me përqindje të ulët të përfaqësimit të femrave në shërbimin civil veçohen komunat: Rahovec, Suharekë, Junik, Deçan, Skenderaj, Vushtrri, Klinë, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Dragash, Malishevës dhe Prizren.

Për dallim nga pozitat vendimmarrëse dhe shërbimi civil, progres është arritur në sektorin e arsimit, përkatësisht në rritjen e përfaqësimit të femrës në mësimdhënie. Në vitin 2015 përqindja e femrave të punësuar është rritur në 40%, krahas vitit 2014 sa ishte 36%.

Në kuadër të veprimeve të komunave për mbështetjen e bizneseve të femrave, subvencione kanë ndarë komunat: Viti, Dragash, Obiliq Glllogovc, Shtime dhe Lipjan, kryesisht në përkrahjen për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve.

2.14. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE

19 Komuna kanë hartuar Planin e Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE, ndërsa 11 Komuna (Mitrovicë jugore, Kamenicë, Viti, Shtërpçë, Graçanicë, Zubin Potok, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Zveçan dhe Leposaviq) ende nuk e kanë hartuar këtë plan. Në 8 komuna (Drenas, Junik, Klllokot, Kaçanik, Dragash, Hani Elezit, Ranillug dhe Partesh) nuk ka komunitet RAE.

Duke iu referuar Planit të Punës, Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe detyrave që dalin nga Plani Aksional për Liberalizimin e Vizave, është realizuar fushata për regjistrim falas. Gjatë kësaj fushate janë identifikuar 233 persona të paregjistruar, prej të cilëve janë regjistruar 90.

Lidhur me arsimimin e këtyre komuniteteve, Komuna e Lipjanit ka organizuar mësim shtesë për tri komunitetet, përkatësisht në fshatin Medvec dhe Gadime e Ulët. Është planifikuar mësimi shtesë të mundësohet edhe në tri lokacione të fshatit Janjevë dhe Magure.

Përfitues të programeve të veçanta për aftësim dhe riaftësim profesional për komunitetin RAE kanë qenë: Obiliq (2 romë), Pejë 120, Prishtina 100 nxënës, Gjakova 10 nxënës, Klinë 2 nxënës, Prisen 20 bursa, Shtimje 4 nxënës.

2.15. Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në komuna

Gjithsej 34 Komuna e kanë të aprovuar rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Këtë rregullore nuk e kanë hartuar dhe miratuar 4 komuna: Komuna e Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit. Përqindja e publikimit të dokumenteve në gjuhët zyrtare komunale në ueb-faqen zyrtare të komunave ka qenë 65%, andaj komunat duhet të ndërmarrin veprime për përkthimin e tyre dhe publikimin e tërësishëm në ueb-faqet komunale. Në shumicën e komunave janë të angazhuar nga 1 ose 2 zyrtarë për përkthim që ofrojnë shërbime të përkthimit me shkrim dhe në të folur. Megjithatë, numri i zyrtarëve nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave për përkthim, duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave dhe akteve juridike të cilat kërkohen të përkthehen në bazë të legjislacionit në fuqi.

2.17. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit të të bërit biznes

Zhvillimi i bizneseve mbetet një nga fushat kryesore për të cilat komunat duhet të ndërmarrin veprime konkrete. Numri i bizneseve të regjistruara online në 24 Komuna është 17637. Në 7 komuna (Klinë, Mitrovicë, Pejë, Shtërpçë, Graçanicë, Kaçanik dhe Partesh) regjistrimi i bizneseve bëhet vetëm në mënyrë fizike dhe numri i tyre është 28,912. Krahës tyre, 4 komuna (Vushtrri, Prizren, Podujevë dhe Zveçan) nuk e praktikojnë ende regjistrimin e bizneseve online, si dhe 3 komuna (Mamushë, Junik dhe Partesh) nuk e kanë themeluar zyrën e regjistrimit të bizneseve.

2.18. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjitha komunitetet minoritare

Ofrimi i shërbimeve për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, si dhe grupet vulnerabile, është një nga prioritetet kryesore në komuna. Të dhënat tregojnë se 32 Komuna kanë mbajtur gjithsej 501 trajnime, fushata dhe aktivitete lidhur me vetëdijesimin mbi rreziqet shëndetësore, sigurimin e shëndetit publik, integritetin e komuniteteve në sistemin shëndetësor, shëndetin e nënës dhe fëmijës. Komuna e Skendrajt, Zubin Potok dhe Shtërpçës kanë ndërmarrë disa aktivitete, mirëpo nuk kanë dhënë numrin e trajnimeve, ndërsa komuna e Ranillugut dhe Leposaviqit nuk kanë realizuar ndonjë aktivitet.

2.19. Bujqësia

Bazuar në të dhënat e pranuar 16 Komuna e kanë të aprovuar Planin për Menaxhimin e Tokave Rurale (zonimi), ndërkaq 22 komuna nuk e kanë hartuar këtë plan (Deçan, Junik, Pejë, Kamenicë, Viti, Skenderaj, Klllokot, Shtërpçë, Graçanicë, Prishtinë, Podujevë, Hani Elezit, Mamushë, Partesh, Novobërdë, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Gjakovë, Gjilan, Obiliq, Vushtrri dhe Leposaviq). Po ashtu, 4 Komuna kanë bërë publikimin e Sistemit Informativ të Tregut (SIT) për artikujt kryesorë ushqimorë, kurse 31 Komuna (Junik, Deçan, Pejë, Mitrovicë, Drenas, Kamenicë, Viti, Skenderaj, Klllokot, Shtërpçë, Graçanicë, Prishtinë, Podujevë, Hani Elezit, Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Lipjan, Kaçanik, Istog, Fushë Kosovë, Dragash, Ranillug, Prizren, Obiliq, Suharekë, Ferizaj, Zubin Potok, Malishevë, Novobërdë dhe Zveçan) nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Lidhur me këtë komuna e Rahovecit, Vushtrrisë dhe Leposaviqit nuk kanë ofruar të dhëna. Vlen të përmendet se 35

Komuna kanë themeluar dhe funksionalizuar Qendrat Informative Këshilluese Bujqësore për fermerë, kurse Komuna e Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit ende nuk i kanë themeluar.

2.20. Infrastruktura rurale

Lidhur me zhvillimet në infrastrukturën rurale, në 30 Komuna, numri i projekteve të investimeve publike në zonat rurale ka qenë 624.

2.22. Përmirësimi i politikave strategjike në fushën e mjedisit dhe miratimi i planeve të veprimit

Kjo përfshinë veprimet e radhës për sa i përket fushës së menaxhimit të mjedisit. 25 Komuna kanë miratuar Planin Hapësinor Komunal, kurse 13 Komuna (Pejë, Klllokot, Fushë Kosovë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Obiliq, Ferizaj, Zubin Potok, Vushtrri, Malishevë, Zveçan dhe Leposaviq) ende nuk e kanë hartuar këtë plan. Po ashtu, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave e kanë hartuar 22 Komuna, ndërsa 13 Komuna (Shtërpçë, Graçanicë, Lipjan, Kaçanik, Zubin Potok, Podujevë, Mamushë, Gjakovë, Gjilan, Suharekë, Vushtrri, Shtime dhe Zveçan) ende nuk e kanë hartuar këtë plan, si dhe 3 komuna (Pejë, Skenderaj dhe Leposaviq) nuk kanë ofruar përgjigje.

2.23. Transporti

Komunat në përgjithësi kanë përmirësuar shërbimet e transportit. Sa i përket linjave aktive të trafikut urban, këto linja janë aktive në 26 Komuna, ndërsa 12 komuna (Rahovec, Viti, Skenderaj, Klllokot, Shtërpçë, Graçanicë, Mamushë, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Ferizaj, Vushtrri dhe Leposaviq) nuk i kanë aktive.

2.24. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi

Në 25 Komuna janë riatdhesuar 350 persona, ndërsa 10 komuna (Kamenicë, Viti, Graçanicë, Dragash, Hani Elezit, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Prizren, Ferizaj dhe Zveçan) nuk kanë persona të riatdhesuar, si dhe 3 komuna (Peja, Zubin Potok dhe Leposaviq) nuk kanë ofruar të dhëna. Në çështjen e sigurisë së dokumenteve, 18 Komuna kanë përfunduar procesin e digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia, ndërsa 20 komuna (Rahovec, Drenas, Viti, Skenderaj, Klllokot, Novobërdë, Shtërpçë, Graçanicë, Dragash, Hani Elezit, Mamushë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Gjakovë, Malishevë, Vushtrri, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë. 32 komuna kanë arritur të ngritin sigurinë fizike të dokumentacionit përmes rojave fizike, vendosjes së kamerave, grilave dhe kasafortave, kurse në 3 komuna (Junik, Klinë dhe Klllokot) ngritja e sigurisë fizike të dokumentacionit është kompletuar pjesërisht në dy komuna (Zubin Potok dhe Zveçan) . Po ashtu, në total në 35 komuna mbahen librat fizik, ndërsa në 1 komunë (Ferizaj) nuk mbahen librat fizik.

2.4. Bashkëpunimi ndërkomunal

Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, sipas mandatit ligjor, gjatë vitit 2015 ka mbikëqyrë komunat në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Gjatë periudhës në fjalë, komunat kanë shtuar aktivitetin në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal, megjithëse ka nevojë shtesë në përforcimin e kapaciteteve të komunavenë këtë proces.

Sipas të dhënave, 14 komuna kanë lidhur marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal, si vijon: Komuna e Shtërpçës, Obiliqit, Mitrovicës Jugore, Kaçanikut, Ferizajit, Deçanit, Drenasit, Garancisë, Lipjanit, Vitisë, Dragashit, Gjakovës, Gjilanit dhe Vushtrrisë. Këto komuna kanë lidhur gjithsej 41 marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal, kryesisht në fushën e infrastrukturës, ambientit, kulturës dhe turizmit, por edhe në fusha të tjera si: punësim, zhvillimin ekonomik dhe rural, arsim dhe shëndetësi. Disa komuna, i kanë kushtuar kujdes edhe zhvillimit të dialogut dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mirëqenies sociale dhe promovimit të sportit.

Komunat e tjera nuk kanë lidhur ndonjë marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal, ndërsa komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë të dhënë në këtë drejtim janë: Komuna e Malishevës, Prizrenit, Kamenicës dhe Komuna e Pejës.

2.5. Përfitimi nga fondet e BE-së

2.5.1. Bashkëpunimi ndërkufitar

Në vijim janë paraqitur grant skemat e financuara nga BE-ja, të cilat kanë ndikim nëpërkrahjen e bizneseve, në promovimin e zhvillimit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e infrastrukturës publike në Kosovë, duke përfshirë projektet:

- Kosova e Bukur II
- Projektet eured IV
- Projektet e grant skemës rurale 2013-2015
- MUNINFRA(Infrastruktura)
- Projektet e bashkëpunimit ndërkufitarë.

Projektet e financuara nga BE janë:

a) Skema “Kosova e Bukur”

Projektet nga Programi Kosova e bukur II, kanë pasur për qëllim ndërtimin e infrastrukturës publike, arsimore, rregullimin e parqeve, objekteve të ndryshme infrastrukturore komunale, ndërtimin e shtigjeve të ecjes, dhe krijimin e hapësirave të gjelbëruara, si dhe rregullimin e shumë objekteve të tjera shëndetësore, të cilat do të i shërbejnë qytetarëve të Kosovës në shfrytëzimin e tyre si dhe do të krijojnë edhe kushte më të mira për punë për zyrtaret të cilët punojnë në objektet e ndërtuara, apo të rregulluara nga Kosova e Bukur II. Komuna të cilat kanë përfituar fonde nga programi i BE-së “Kosova e Bukur” janë paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig.15. Komunat përfituese nga programi i BE-së “Beautiful Kosovo”

Sipas të dhënave, vërejmë se gjithsej përfituese nga ky program kanë qenë 25 komuna në vlerën prej 3,688,390.57€.

b) Skema EURED 4

Nga kjo skemë, në rajonin e Qendrës janë financuar këto projekte: “Krijimi i tregjeve mobile për fermerët e Prishtinës”; “Hapja e qendrës për mbledhjen, magazinimin dhe shpërndarjen e frutave dhe perimeve në rajonin e Llapit dhe Gollakut”; “Mbështetja në zbatimin e Energjisë Efiçiente për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe ndërmarrjen e masave në sektorin publik dhe privat” dhe “Zhvillimi i Akademisë II - Forcimi i kapaciteteve të Zhvillimit të Institucioneve Qëndrore, bizneseve dhe shoqatat e fermerëve”. Vlera e përgjithshme e projekteve dhe përqindja e financimit nga BE është paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig 16. Vlera totale e projekteve në Rajonin Qendër dhe përqindja e financimit nga BE

Sa i përket rajonit Lindje, janë financuar këto projekte: “Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomiksi mjet për pajtimin e komuniteteve në rajonin Lindje”, “Mbështetja e bizneseve bujqësore në rajonin e Gjilanit”, dhe “Rritja e konkurrencës, cilësia e produktit dhe shitjet e përpunuesve të drurit në Ferizaj, Kaçanik dhe Shtërpçë”. Vlera e përgjithshme e projekteve dhe përqindja e financimit nga BE është paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig 17. Vlera totale e projekteve në Rajonin Lindje dhe përqindja e financimit nga BE

Në rajonin e Perëndimit, janë financuar këto projekte: “Ringjallja e pazarit të vjetër të artizanaleve në Rajonin e Perëndimor të Kosovës”, “Mbështetja e agro-bizneseve të Istogut në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës publike me impakt direkt në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të lira të punës”, “Kuçja e grave në agro-biznes në rajonin perëndimor të Kosovës” dhe “Përpunimi dhe promovimi i një plani unik të përpunimit të frutave pyjore”. Vlera e përgjithshme e projekteve dhe përqindja e financimit nga BE është paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig 18. Vlera totale e projekteve në Rajonin Lindje dhe përqindja e financimit nga BE

Në rajonin e Veriut janë financuar këto projekte: "Krijimi i një platforme ekonomike dhe të zbatueshme për mbledhjen dhe paketimin e mbeturinave të riciklueshme në Komunën e Vushtrrisë" si dhe "Mbështetja e bizneseve të Mjedisit që të fillojnë punën në Veri dhe Jug të Mitrovicës". Vlera e përgjithshme e projekteve dhe përqindja e financimit nga BE është paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig 19. Vlera totale e projekteve në Rajonin Veridhe përqindja e financimit nga BE

Në rajonin Jug është financuar projekti "Zhvillimi Bujqësor dhe ekonomik në rajonin Jug të Kosovës. Vlera e përgjithshme e projektit ka qenë 465,179.56 euro, ndërsa BE ka financuar 90% të vlerës së projektit.

c) Projektet e grant skemës rurale 2013-2015

Projektet nga grant skema rurale 2013-2015 kanë për synim mbështetjen e sektorit të bujqësisë në Kosovë, përmes nxitjes së prodhimit të qumështit, zhvillimin e zonave rurale, promovimin e turizmit (në rajonin e Lindjes), promovimin dhe përkrahjen e bizneseve të cilat brenda planit të tyre bujqësor kanë prioritet ruajtjen e ambientit dhe eficienten e energjisë.

Të gjitha këto projekte nga skema rurale 2013-2015 kanë për qëllim përkrahjen e bizneseve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomiko-sociale në të gjitha rajonet ekonomike në Kosovë. Rajoni me më shumë projekte përfituese nga kjo skemë ka qenë rajoni i Lindjes (me tri projekte të përfituara), kurse rajoni me më pak projekte të përfituara ka qenë rajoni i Qendrës. Vlera totale e projekteve të financuara është 3,711,079.38 euro.

C) MUNINFRA (Programi i infrastrukturës komunale)

Programi i Infrastrukturës Komunale, është projekt mbështetës për komunat, për ndërtimin dhe përmirësimin e Infrastrukturës Komunale, i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, (MAPL) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, (ZBEK).

Projektet e Infrastrukturës Komunale, janë realizuar në pesë rajonet socio-ekonomike të Kosovës, Qendër, Veri, Jug, Perëndim dhe Lindje. Rajoni i cili ka propozuar më së shumti projekte, të cilat janë miratuar nga MAPL dhe Bashkimi Evropian, në skemën e infrastrukturës lot 7a, është rajoni Lindjes me 5 projekte. Ndërsa, rajoni më së paku projekte përfituese nga skema e infrastrukturës komunale në lot 7a, është rajoni i Perëndimit dhe Jugut me vetëm 1 projekt.

Në kuadër të grantit të infrastrukturës komunale 2015 të dhënë nga MAPL për komuna, si përfitues kryesorë kanë qenë Rajoni i Veriut dhe i Lindjes, për shkak të projekteve më konkurruese, të cilat kanë plotësuar kushtet e bashkëfinancimit nga MAPL dhe komuna. Kurse, rajoni me projekte më pak të përkrahura nga ky grant, është rajoni Jugut me 4 projekte të fituara.

Ç) Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar

Në kuadër të projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar, kanë qenë projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Shqipëri dhe Kosovë-Maqedoni.

- Programi BNK Kosovë-Shqipëri

Qëllimi i programit të bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Shqipëri ka qenë:

- Nxitja e bizneseve të reja ekologjike,
- Promovimi i bizneseve ekzistuese ekologjike;
- Promovimi dhe shpërndarja e ekspertizës për bizneset ekologjike;
- Ngritja dhe zhvillimi i Infrastrukturës, si mbështetje për bizneset ekologjike.

Gjithashtu, në programin e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Shqipëri, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve, ndërmarrjeve dhe institucioneve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, si dhe ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta.

Në kuadër të Rajonit Jug, nga Komisioni Evropian janë financuar 4 projekte në vlerën prej 976,622.92€, prej të cilave 516,807.05€ u janë ndarë partnerëve të Kosovës, kurse 459,815.87€ u janë ndarë partnerëve të Shqipërisë. Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat për projektet e financuara:




Fig.20. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Shqipëri, Rajoni Jug




Fig.21. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Shqipëri, Rajoni Perëndim

- Programi BNK Kosovë-Maqedoni

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Maqedoni është bazuar në këto prioritete:

- Zhvillimi ekonomik e social dhe promovimi i resurseve natyrore dhe kulturore dhe përfshin dy masa;
- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor;
- Avancimi i kohezionit social në suaza të veprimeve ndër-njerëzore;

Në total janë financuar 6 projekte, në vlerën prej 2,636,581.53 €, prej të cilave 1,307,558.87 janë ndarë për partnerët e Kosovës dhe 1,329,022.66 për të Maqedonisë.




Fig.22. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, Rajoni Lindje




Fig.23. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, Rajoni Jug




Fig.24. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, Rajoni Lindje-Jug




Fig.25. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, Rajoni Qendër, Lindje, Jug

PJESA 3

3. Buxhetet e komunave

Komunat e Republikës së Kosovës financohen nga grantete qeverisë dhe nga të hyrat vetanake të mbledhura për ofrimin e shërbimeve komunale. Në vijim janë paraqitur të dhënat për realizimin e të hyrave vetanake nga komunat dhe realizimin e shpenzimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2015.

3.1. Realizimi i të hyrave vetanake

Në vitin 2015, komunat kanë planifikuar të hyra vetanake në vlerë prej 74,243,215.00 €. Planifikimi në këtë vit ka qenë më i madh se në vitin 2014 sa ishte në vlerën prej 67,285,971.00 €. Në vitin 2015 komunat kanë mbledhur të hyra vetanake në vlerën prej 58,364,205.40€ ose 79% nga niveli i planifikimit vjetor prej 74,243,215.00 €. Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015 janë mbledhur 2,566,621.38€ (ose 4,2%) të hyra vetanake më pak se në vitin 2014 sa ishin 60,930,226.78 €.

Ndikim më të madh në krijimin e të hyrave vetanake janë të hyrat nga tatimi në pronë, i cili gjatë vitit 2015 është inkasuar në vlerën prej 19,914,321 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 (sa ishte 20,411,152 €), në vitin 2015 nga kjo kategori janë mbledhur 2% më pak të hyra nga tatimi në pronë.

Gjithashtu, nga të hyrat komunale për lejet ndërtimore, gjatë vitit 2015 janë inkasuar mjete në vlerën prej 12,020,331 €, që është 7.9% më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit 2014 e cila ishte 11,136,199 €.

Në vijim është paraqitur figura me përqindjen e realizimit të të hyrave vetanake të komunave në vitin 2015 në raport me planifikimin.




Fig. 26. Përqindja e realizimit të të hyrave në raport me planifikimin

Nga të figura e mësipërme vërejmë se komunat të cilat kanë tejkaluar planin e realizimit të hyrave vetanake janë: Obiliq (129%) ; Ranillugë (122%); Graçanicë (113%); Fushë-Kosovë (112%); Lipjan (110%) dhe Klllokot (106%).

Në nivelin e realizimit nga 80% deri ne 100% janë komunat: Peja (100%); Shtime (85%); Rahoves (92%); Suharekë (87%); Malishevë (80%); Mamushë (82%); Deçan (99%); Gjakovë (86%); Istog (93%); Klinë (93%); Junik (86%); Skenderaj (94%); Vushtrri (84%); Gjilan (94%); Kaçanik (80%); Novobërdë (93%); Ferizaj (84%); Partesh (89%); Hani i Elezit (88%);

Në nivelin e realizimit nga 50% deri ne 80% janë komunat: Glogoci (75%); Podujevë (75%); Prishtinë (67%); Dragash (72%); Prizren (64%); Mitrovicë (72%); Kamenicë (77%); Shtërpce (69%); Viti (78%).

Komunat që kanë realizuar të hyra vetanake nën 50% janë: Leposavic (46%); Mitrovica Veriore (30%); Zveçani (25%); Zubin Potoku(15%).

3.2. Shpenzimet e Buxheteve Komunale

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2015 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 412,837,588.65€ ose 90% të buxhetimit në vlerë prej 456,575,573.41 €.

Buxheti i komunave për vitin 2015 ka qenë më i madh për 10,625,130.97€ në krahasim me buxhetin e vitit 2014 (prej 445,950,442.44 €).

3.2.1. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi është shpenzuar, si vijon:

- Kategorja e rrogave dhe pagave është buxhetuar në vlerë prej 242,897,402.62 €, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 242,197,714.80 €, ose 100%;
- Kategorja e mallrave dhe shërbimeve është buxhetuar në vlerë prej 41,222,661.30 € ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 37,535,246.77 € ose 91%;
- Shpenzimet komunale të buxhetuara në vlerë prej 10,306,296.43 € janë shpenzuar 9,509,405.40 €, ose 92%;
- Subvencione dhe transfere të buxhetuara në vlerë prej 11,813,452.86 € janë shpenzuar 9,370,287.14 € ose 79%;
- Kategorja e shpenzimeve kapitale të buxhetuara në vlerë prej 150,335,760.20 € janë shpenzuar 114,224,934.54 €, ose 76%⁴.

⁴Shih Grafikun Nr..4.3. Paraqitja grafike e shpenzimeve komunale sipas kategorive ekonomike për vitin 2015

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se kategoria e pagave dhe mëditjeve është shpenzuar më së shumti (100%), ndërsa më së paku është shpenzuar kategoria e shpenzimeve kapitale (76%) krahasuar me buxhetimin. Kategoria e pagave dhe mëditjeve krahasuar me planifikimin në 38 komuna është shpenzuar prej 98 %– 100 % të nivelit vjetor.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me buxhetimin në 23 komuna është shpenzuar në nivelin nga 90% - 100%, në 13 komuna në nivelin prej 80 - 89%, ndërsa në 2 komuna në nivelin 75-79%.

Kategoria e shpenzimeve komunale krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 26 komuna; në 8 komuna është shpenzuar në nivelin 70% - 89%; në komunë e Klllokotit është shpenzuar 57%; në Zvecan 38%, kurse në Mitrovicë Veriore 15%. Këtu vlen të ceket se komuna e Zubin Potokut me 1% është komuna me shpenzim më të ulët të nivelit vjetor të buxhetuar.

Kategoria e subvencioneve dhe transfereve krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 25 komuna; në 6 komuna është shpenzuar në nivelin 76% - 89%; në 4 komuna në nivelin 58%– 68%; në komunën e Klllokotit është shpenzuar 27%; në Komunën e Zveqanit me zero shpenzim.

Kategoria e shpenzimeve kapitale (pasuritë jofinanciare) krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 8 komuna 90% - 98-%; në 17 komuna është shpenzuar 81% – 88%; në 9 komuna është shpenzuar 54% – 78%; dhe në 4 komuna është shpenzuar nën 50% (komuna e Klllokotit ka shpenzuar 35%; komuna e Zveqanit 28%; komuna e Mitrovicës Veriore ka shpenzuar 18% dhe Zubin Potok ka shpenzuar 7% të nivelit vjetor të buxhetuar).

Gjithsej 33 komunat kanë arritur të shpenzojnë në total buxhetin në nivel më të lartë prej 87% - 98% të nivelit vjetor të buxhetuar. Komunitat të cilat nuk kanë arritur këtë nivel janë:

- Leposaviqi 81%;
- Prishtina 80%;
- Komuna e Zveqanit 53%,
- Mitrovica Veriore 54%
- Zubin Potokut (49%).

Në vijim kemi paraqitur grafikun e shpenzimeve komunale për vitin 2015:




Fig. 27. Pasqyra e shpenzimeve te komunave në vitin 2015 e shprehur në përqindje




Fig. 28. Përqindja e shpenzimeve sipas kategorive buxhetore

3.3. Opinionet e Auditorit të Përgjithshëm

Opinionit i cili më së shumti është dhënë në vitet 2013 dhe 2014 është opinion pa rezervë (i pa kualifikuar) me theksim të çështjes. Në vijim janë paraqitur opinionet e auditorit të përgjithshëm sipas viteve:

- Opinion pa rezervë (i pa kualifikuar) - Ky opinion në vitin 2013 është dhënë në 20 komuna, ndërsa në vitin 2014 në 17 komuna.
- Opinionit i pakualifikuar – çështje tjetër - Në vitin 2013 është dhënë në 11 komuna, ndërsa në vitin 2014 nuk është dhënë në asnjë komunë.
- Opinion me theksim të çështjeve ose çështje tjera - Në vitin 2013 nuk është dhënë në asnjë komunë, kurse në vitin 2014 këtë lloj opinionit e kanë marrë 5 komuna.
- Opinionit me rezervë (i kualifikuar) me theksim të çështjes - Në vitin 2013 është dhënë në 3 komuna, ndërsa në vitin 2014 në 11 komuna.
- Opinionit – Mohim i opinionit - Në vitin 2013, ky opinion është dhënë për 2 komuna, ndërsa në vitin 2014 është dhënë për 4 komuna.

Opinionit i cili iu mundëson komunave për të filluar me procedura të huasë komunale është opinionit pa rezervë (pa kualifikim). Këtë opinion e kanë marrë 2 komuna në vitin 2013 (Shtime dhe Ranullug), ndërsa në vitin 2014 e ka marrë vetëm 1 komunë (Hani i Elezit). Meqenëse për të plotësuar kriterin për huamarrje komuna duhet të dëshmojë marrjen e opinionit të pa rezervë në dy vitet e fundit, sipas të dhënave ky kriter nuk është plotësuar në asnjë komunë.

Nga raportet e publikuara të auditorit të përgjithshëm për vitet 2013 dhe 2014 mund të themi se të gjeturat, në përgjithësi kanë të bëjnë me: shpalosjen e nevojshme në pasqyrat financiare,

shpalosjen e pasurive, pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme, regjistrin e pasurive fikse, shpalosjen në mënyrë të plotë dhe të saktë të informacioneve për pasuritë dhe stoqet, regjistrin e pasurive fikse që ende nuk është plotësisht i besueshëm, mos klasifikimine duhur të shpenzimeve (nga kodi i investimeve kapitale janë bërë pagesa për subvencione dhe transfere dhe mallra dhe shërbime), evidencat dhe informatat e prezantuar tek shpalosjet e të hyrave vetanake, stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme (të cilat nuk janë prezantuar të sakta), pasuritë jo-financiare (investimet kapitale) që nuk janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë, gjendja e stoqeve të materialit zyrtar (që nuk është shpalosur plotësisht), objekte dhe prona publike të paregjistruara, klasifikim të gabuar të shpenzimeve, pagesa për punëtor pa qenë të angazhuar, pagesa nga kategoria e investimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, dosje të pakompletuara të personelit dhe angazhimi i stafit pas kontrata, mos prezantimi i detyrimeve kontingjente lidhur me kontestet gjyqësore.

Në vijim mund të shihni pasqyrën me të dhëna lidhur me këto opinione të auditorit sipas komunave dhe sipas viteve.

Pasqyra e përgjithshme e opinioneve të auditorit të përgjithshëm sipas komunave dhe sipas viteve është si në vijim:

Opinionit i auditorit	Vitet	Komunat
Opinion pa rezerve (pa kualifikuar ose pamodifikuar)	2013	Shtime, Ranillug
	2014	Hani i Elezit
Opinion me rezerve (i kualifikuar) me Theksim të çështjes	2013	Partesh, Mitrovicë, Lipjan
	2014	Malishevë, Klinë, Junik, Rahovec, Glogoc, Vushtrri, Suharek, Pejë, Novëbërdë, Istog, Gjakovë
Opinion i (pakualifikuar ose pamodifikuar) me Theksim të çështjes	2013	Rahovec, Glogoc, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Zveqan, Vushtrri, Suharek, Shtërpce, Prizren, Podujevë, Pejë, Novobërdë, Klokot, Istog, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Prishtinë
	2014	Mamushë, Kamenicë, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Shtime, Shtërpce, Ranillug, Prizren, Podujevë, Partesh, Mitrovicë, Lipjan, Klokot, Gjilan, Fushë-Kosovë, Prishtinë, Ferizaj
Opinion i (pakualifikuar ose pamodifikuar) - Çështje tjera	2013	Viti, Skenderaj, Mamushë, Malishevë, Klinë, Kamenicë, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit, Dragash, Deçan
	2014	
Mohim i opinionit	2013	Zubin Potok, Leposaviq
	2014	Zveqan, Zubin Potok, Leposaviq, Graçanicë
	2013	
Theksim i çështjeve-Çështje tjera	2014	Vitia, Skenderaj, Kaçanik, Dragash, Deçan

Konkluzionet e përgjithshme

Në bazë të asaj që kemi pasqyruar në këtë raport del se:

- Komunat në përgjithësi kanë përmbushur obligimet ligjore për mbajtjen e 10 mbledhjeve të parapara brenda një viti, në përjashtim të Komunës së Prishtinës e cila ka mbajtur 9 mbledhje.
- Prej 38 komunave, vetëm gjysma e tyre kanë themeluar Komitete Konsultative, bazuar në nenin 73 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.
- Në përgjithësi komunat kanë realizuar obligimin e tyre ligjor për mbajtjen e së paku 2 takimeve publike brenda vitit 2015, me përjashtim të komunës së Fushë Kosovës e cila nuk ka mbajtur asnjë takim, si dhe komunat e Mitrovicës Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq të cilat kanë mbajtur vetëm nga 1 takim publik me qytetarë.
- Në 38 komuna janë mbajtur 581 konsultime publike me qytetarë, para miratimit të projekt-akteve të komunës, propozim-buxheteve, planeve, rregulloreve, etj.
- Shumica e kryetarëve të komunave e kanë përmbushur obligimin për raportim para kuvendit të komunës. Kryetarët e komunave nuk kanë raportuar para kuvendeve të komunave: Prishtinë, Glogoc, Klinë, Novobërdë, Partesh dhe Kllokot, të cilët nuk e kanë përmbushur këtë obligim.
- Kuvendet e komunave kanë qenë aktive në miratimin e akteve komunale. Më aktive në këtë drejtim kanë qenë komunat: Vushtrri, Pejë, Gjakovë, Novobërdë, Klinë, Gjiilan, Obiliq, Rahovec, Malishevë, Ferizaj, Kaçanik dhe Mitrovicë Jugore;
- Në përgjithësi komunat kanë funksionalizuar dhe kanë publikuar aktet komunale në faqet zyrtare të tyre sipas Rregullores Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Janë konstatuar 39 shkelje ligjore në 17 komuna. Komunat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar aktet në kuvendet e komunave pas kundërshtimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës apo i kanë rishqyrtuar duke mos i ndryshuar aktet e tilla në përputhje me rekomandimet përkatëse, janë: Prishtina, Gjakova, Parteshi Kllokoti, Malisheva, Lipjani, Obiliqi, Novobërda dhe Graçanica.
- Gjatë vitit 2015 janë mbajtur 885 trajnime nga niveli qendror për zyrtarët komunal në 38 komuna. Përfitues nga këto trajnime kanë qenë gjithsej 2079 zyrtarë të komunave;
- Zyra për Promovimin e Investimeve është themeluar në 10 komuna (Drenas, Viti, Skenderaj, Lipjan, Dragash, Novobërdë, Gjakovë, Gjiilan, Shtime dhe Suharekë;
- Komunat kanë siguruar hapësirat e nevojshme të punës për institucionin e Avokatit të Popullit.
- Vetëm 19 komuna e kanë hartuar programin për ngritjen e kapaciteteve për shërbyesit civil në administratën komunale.

- Sfiduese mbetet zbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Në këtë drejtim, Komunitet: Pejë, Mitrovicë, Klokot, Prishtinë dhe Malishevë nuk i kanë zbatuar 40 vendime të KPMSHC-së.
- Në 5 Komuna (Klinë, Kamenicë, Istog, Dragash dhe Malishevë) ka pasur 13 raste të deklarimeve të konfliktit të interesit;
- Në komunitet: Suharekë, Viti, Deçan, Glogovc, Novobërdë dhe Mamushë nuk janë caktuar zyrtarët për të drejtat e fëmijëve;
- 18 Komuna e kanë hartuar Rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa 20 komuna ende nuk e kanë hartuar këtë rregullore;
- Progres të konsiderueshëm është parë edhe në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, me ç'rast 26 Komuna kanë të punësuar 96 persona me aftësi të veçanta.
- Rol të rëndësishëm gjatë vitit 2015 ka pasur edhe fuqizimi i pozitës së femrës. Në 36 Komuna janë gjithsej 230 femra në pozita menaxheriale. Komunitet të cilat nuk kanë të punësuar femra në pozita menaxheriale janë: Klokoti dhe Mamusha. Në 38 komuna, përfshirë administratën dhe kuvendet e komunave, numri i përgjithshëm i femrave të punësuar është 2127. Megjithatë, përfshirja e femrave në shërbimin civil nuk është e mjaftueshme.
- Më shumë se gjysma e komunave kanë hartuar Planin e Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE, ndërsa nuk e kanë hartuar Komunitet: Mitrovicë, Kamenicë, Viti, Shtërpçë, Graçanicë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.
- Gjithsej 34 Komuna e kanë të aprovuar rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Këtë rregullore nuk e kanë hartuar dhe miratuar Komunitet: Mitrovicës Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.
- Në shumicën e komunave regjistrimi i bizneseve është bërë online.
- 16 Komuna e kanë të aprovuar Planin për Menaxhimin e Tokave Rurale, ndërkohë 22 komuna nuk e kanë hartuar këtë plan.
- Shumica e komunave e kanë themeluar dhe funksionalizuar Qendrat Informative Këshilluese Bujqësore për fermerë, kurse Komuna e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit ende nuk e ka themeluar.
- Në përgjithësi komunitet kanë pasur një progres të konsiderueshëm në infrastrukturën rurale. Në 30 komuna, janë realizuar 624 projekte të investimeve në zonat rurale ka qenë 624.
- Komunitet kanë shënuar progres edhe sa i përket pyllëzimit të sipërfaqeve. Sipas të dhënave, në 24 Komuna janë pyllëzuar 27,541.4 hektar sipërfaqe. Gjithashtu, 23 Komuna kanë miratuar Planin Menaxhues për Pyjet. Në anën tjetër, vetëm 7 Komuna kanë krijuar Sistemin Informativ Pyjor (SIP);

- Planin për Menaxhimin e Mbeturinave e kanë hartuar 22 Komuna, ndërsa nuk është miratuar në komunat: Shtërpçë, Graçanicë, Lipjan, Kaçanik, Podujevë, Mamushë, Gjakovë, Gjiilan, Suharekë, Vushtrri, Zubin Potok, Shtime dhe Zveçan. Komunat të cilat nuk kanë ofruar informata janë: Pejë, Skenderaj dhe Leposaviq.
- Në 25 Komuna janë riatdhesuar 350 persona. Komuna e Pejës, Zubin Potok dhe Leposaviqit nuk kanë ofruar të dhëna.
- 33 komuna e kanë miratuar Planin Lokal të Veprimit për Riintegrim, ndërsa komunat të cilat nuk e kanë miratuar janë: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq;
- 18 Komuna kanë përfunduar procesin e digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia, ndërsa 20 komuna (Rahovec, Drenas, Viti, Skenderaj, Klllokot, Novobërdë, Shtërpçë, Graçanicë, Dragash, Hani Elezit, Mamushë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Gjakovë, Malishevë, Zubin Potok, Vushtrri, Zveçan dhe Leposaviq) ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë;
- 32 komuna kanë arritur të ngritin sigurinë fizike të dokumentacionit përmes rojave fizike, vendosjes së kamerave, grilave dhe kasafortave;
- Komunat kanë lidhur gjithsej 41 marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal, kryesisht në fushën e infrastrukturës, ambientit, kulturës dhe turizmit;
- Komunat po ashtu kanë përfituar nga programet e BE-së: *“Beautiful Kosovo”*, Kosova e Bukur II, Projektet EURED IV, Projektet e Grant Skemës Rurale 2013-2015, MUNINFRA (Infrastruktura), Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar.
- Progres është parë edhe në planifikimin dhe në realizimin e të hyrave vetanake. Komunat kanë mbledhur të hyra vetanake në vlerën prej 58,364,205.40€ ose 79% nga niveli i planifikimit vjetor prej 74,243,215.00 €. Krahas mbledhjes së të hyrave, buxhetet e komunave janë shpenzuar në vlerën e përgjithshme prej 412,837,588.65€ ose 90% të buxhetimit në vlerë prej 456,575,573.41 €;
- Në përgjithësi në komunat e Republikës së Kosovës vërehet progres i theksuar pothuajse në të gjitha fushat e specifikuar krahasuar me vitin e kaluar. Shihet se komunat kanë përmirësuar edhe performancën e tyre, kanë ngritur kapacitetet njerëzore dhe kanë qenë më bashkëpunuese dhe koordinuese në raport me nivelin qendror.

Rekomandime

Në përputhje me konkluzionet e këtij raporti për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës kemi nxjerr këto rekomandime për komunat dhe institucionet komunale, si vijon:

- Rekomandohet Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të përmbush obligimin ligjor për mbajtjen e së paku 10 takimeve të kuvendit të komunës brenda një viti kalendarik;
- Rekomandohet komunat të cilat nuk kanë themeluar komitetet konsultative, që t'i themelojnë këto komitete në përputhje me dispozitatat ligjore, sipas nevojave dhe kërkesave specifike të secilës komunë;
- Rekomandohen komunat: Fushë-Kosovë, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq që të mbajnë së paku dy takime publike me qytetarë brenda vitit. Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë janë të përcaktuara në bazë të nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisjes lokale, e cila është normë e obligueshme. Komunat duhet të respektojnë nenin e lartpërmendur për të mundësuar informimin e drejtë të qytetarëve lidhur me politikën, planet, aktet dhe në përgjithësi për ecurinë e punëve të komunës.
